



MIRATOHET  
KRYETARI I BASHKISË

---

BENET BECI

Detyrë Projektimi  
për objektin:  
Rikonstruktion Rruga "Bregu i Detit"  
Velipojë Loti II

Shkodër, 2026



## **PËRMBAJTJA**

|                                                                              |    |
|------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1. Të dhëna të përgjithshme .....                                            | 3  |
| 2. Qëllimi i projektit.....                                                  | 4  |
| 3. Gjendja ekzistuese.....                                                   | 4  |
| 4. Kërkesat e projektit .....                                                | 6  |
| 4.1. Infrastruktura rrugore dhe sipërfaqësore.....                           | 6  |
| 4.2. Kanalizimet e ujërave të zeza .....                                     | 6  |
| 4.3. Kanalizimet e ujërave të bardha .....                                   | 7  |
| 4.4. Rrjeti i ujësjellësit.....                                              | 7  |
| 4.5. Sistemi i ndriçimit rrugor .....                                        | 7  |
| 4.6. Rrjeti i furnizimit me energji elektrike dhe I telekomunikacionit ..... | 8  |
| 4.7. Gjelbërimi dhe mobilimi urban .....                                     | 8  |
| 4.8. Sinjalistika dhe siguria rrugore.....                                   | 8  |
| 4.9. Kosto e projektit.....                                                  | 9  |
| 5. Shërbimet e kërkuara.....                                                 | 9  |
| 6. Paraqitje e dokumentacionit .....                                         | 13 |
| 7. Standardet në projektim .....                                             | 14 |
| 8. Raportimi .....                                                           | 14 |

## 1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Zona e ndërhyrjes shtrihet përgjatë pedonale së plazhit në rrugën “Bregu i Detit” në Njësinë Administrative Velipojë. Zona e ndërhyrjes kufizohet me rrugën e Qendrës Shëndetësore pranë Rrugës numër "7" në anën perëndimore, me Parkun e Lojërave në qendër të plazhit në anën lindore dhe përgjatë gjithë gjatësisë lidh rrugët perpendikulare të aksesit të plazhit. Rruga është e rrethuar me lokale shërbimi, ambiente tregtare, hotele dhe shtëpi private. Kjo rrugë i shërben të gjithë turistëve dhe banorëve të zonës për akses optimal me infrastrukturën e plazhit. Aktualisht në këtë segment mungon infrastruktura mbi dhe nën tokësore.

Projekti parashikon rikonstruksionin e plotë të këtij segmenti, duke përfshirë punime të rrjeteve të infrastrukturës publike (rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha, të ujërave të zeza, rrjeti i telekomunikacionit, rrjeti i furnizimit me energji elektrike, ndriçimit, riparimi dhe zëvendësimi i shtresa rrugore, trotuare, gjelbërim, etj.), duke përmirësuar lëvizshmërinë, sigurinë dhe cilësinë jetës së banorëve dhe duke nxitur ekonominë e zonës.

Përfitues të drejtpërdrejtë nga zbatimi i projektit do të jenë gjithë banorët e zonës dhe turistët e plazhit.

|                                 |                                       |
|---------------------------------|---------------------------------------|
| Vendndodhja:                    | Rruga "Bregu i Detit", Nj.A. Velipojë |
| Koordinatat gjeografike KRGJSH: | 452046.322, 4636536.777               |
| Sipërfaqja totale e ndërhyrjes: | 2160 m <sup>2</sup>                   |
| Gjatësia totale e ndërhyrjes:   | 270 ml                                |
| Harta e shtrirjes së projektit: |                                       |



## 2. QËLLIMI I PROJEKTIT

Projekti për Rikonstruksimin e Rrugës "Bregu i Detit" Velipojë Loti II synon përmirësimin e aksesit, lëvizshmërisë dhe infrastrukturës ndërlidhëse duke synuar zhvillimit të ekonomisë lokale.

Qëllimi i projektit konsiston në rikualifikimin e trupit të rrugës, hapësirës publike dhe elementeve përbërës të saj, për krijimin një infrastrukture të sigurtë, efikase dhe të qëndrueshme për të gjithë përdoruesit. Ndërhyrja në rrjetin nëntokësor, mbitokësor, ndriçim, gjelbërim etj. rrit cilësinë dhe sigurinë e jetës së banorëve në zonat më pak të zhvilluara.

Projekti Rikonstruksim Rruga "Bregu i Detit" Velipojë Loti II ka për qëllim të kontribuojë në arritjen e këtyre rezultateve:

- Përmirësimi i aksesit, lëvizshmërisë, infrastrukturës ku shtrihet ndërhyrja;
- Rikualifikimin e rrugës dhe elementeve përbërës të saj, krijimin e hapësirave dhe infrastrukturës publike sipas standardeve bashkëkohore në shërbim të komunitetit.
- Përmirësimi i ekonomisë lokale si rezultat i përmirësimit të shërbimeve.

## 3. GJENDJA EKZISTUESE

Gjendja ekzistuese në të gjithë sipërfaqen e kësaj rruge paraqitet tejte e amortizuar. Aksi është i rrethuar me ndërtesa 1 - 6 katëshe. Hapësira publike dhe rrugët e shërbimit paraqiten me probleme pasi ka mungesa të shtresave asfaltike duke e bërë këtë segment shumë të vështirë për t'u kaluar dhe përdorur nga banorët.

Nga verifikimet paraprake u konstatuan këto mangësi:

- Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha nuk ekziston;
- Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza është në gjendje të mirë, por duhet verifikuar nëse shtrirja e tij mbulon të gjithë përdoruesit;
- Rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm ekziston, por duhet verifikuar gjendja dhe shtrirja e tij;
- Rrjeti i ndriçimit rrugor ekziston, por është i vendosur në mënyrë që ti shërbejë vetëm pedonales përbri;
- Rrjeti ekzistues i furnizimit me energji elektrike dhe rrjeti i telekomunikacionit kalojnë mbi trupin e rrugës dhe janë të pa sistemuara;
- Hapësirat publike të shtruara mungojnë;
- Trotualet janë vetëm pjesë sporadike dhe të pakoordinuara të vendosura nga vetë banorët dhe në të gjitha pjesët e tjera mungojnë;
- Gjelbërimi i lartë dhe i ulët mungon;
- Sinjalistika rrugore horizontale dhe vertikale ka mangësi.





## 4. KËRKESAT E PROJEKTIT

Hartimi i projektit për objektin: Rikonstruksion Rruga "Bregu i Detit" Velipojë Loti II do të përfshijë si infrastrukturën sipërfaqësore ashtu dhe atë nëntokësore (kanalizime K.U.B., kanalizime K.U.Z., ujësjellës, rrjet telekomunikacioni, rrjet të furnizimit me energji elektrike, ndriçim, trotuare, gjelbërim, parkim etj.)

### 4.1. INFRASTRUKTURA RRUGORE DHE SIPËRFAQËSORE

Shtresat rrugore dhe të trotuareve duhet të parashikohen të tilla që të sigurojnë qëndrueshmëri dhe të përballojnë kapacitetet faktike dhe të perspektivës. Grupi i projektimit duhet të studiojë fluksin aktual të trafikut, përdorimin e rrugës dhe, duke u mbështetur në planin e zhvillimit të zonës, duhet të propozojë projektin e shtresave për çdo pjesë të sheshit. Materialet që do përdoren dhe jetëgjatësia e projektimit të elementeve të sheshit duhet të jetë sipas VKM 628 / 2015 “Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve” dhe duhet të argumentohet me një analizë ekonomike.

Gjeometria e rrugës dhe e trotuareve duhet të përgjigjet kërkesave të lëvizshmërisë së banorëve duke maksimizuar hapësirat e shfrytëzueshme publike. Duhet të merren parasysh si nevojat e përditshme ashtu edhe ato në raste emergjente. Gjatë hartimit të projektit të shikohet mundësia e realizimit të korsisë së biçikletave dhe parkimit të automjeteve. Në pjesët e ndërprerjes së trotuareve të parashikohet ndërtimi i panduseve të kalimit në nivel rruge-trotuar për personat me aftësi të veçanta.

Skema e qarkullimit/lëvizjes duhet të hartohet në mënyrë të tillë që të sigurojnë:

- Aksesibilitetin për të gjitha kategoritë e mjeteve, duke përfshirë rastet dhe mjetet e emergjencës (sidomos ato të zjarrit, shëndetit etj.);
- Parashikimin e mënyrës së lidhjes së rrugës me akset kufitare;
- Aksesibilitetin e këmbësorëve duke i dhënë një përparësi të qartë në rezervimin e hapësirës së lëvizjes si dhe duke parashikuar lidhjen e lëvizshmërisë së tyre në zonë;
- Aksesibilitetin e biçikletave dhe rezervimin e sipërfaqeve për parkimin e tyre;
- Aksesibilitetin e personave me aftësi të veçanta;
- Shfrytëzimin efektiv të rrugës, parashikim parkimi për rezident dhe sidomos parashikimi i vend-parkimit për personat me aftësi të kufizuar;
- Të gjithë elementët e mësipërm të ndërthuren në një projekt sinjalizimi rrugor duke siguruar një organizim të lëvizjes, që përmbush kërkesat si të banorëve ashtu dhe të aktiviteteve të mundshme ekonomike të zonës;
- Plotësimin e elementëve të sigurisë rrugore duke trajtuar me kujdes të gjithë elementët (kalimet këmbësore, këndet e shikimit, ndriçimi, etj.).

### 4.2. KANALIZIMET E UJËRAVE TË ZEZA

Për rrjetin e kanalizimeve të merret paraprakisht informacion i detajuar pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër, të përcaktohet pika funksionale e lidhjes me rrjetin ekzistues, si dhe të kryhen azhurnimet e nevojshme në terren.

Duhet të përcaktohet rrjeti KUZ duke përfshirë pozicionimin, dimensionimin dhe orientimin për të siguruar fluksin e lirë të ujërave të zeza. Profilet e kanalizimeve dhe thellësia duhet të sigurojnë qëndrueshmërinë e infrastrukturës.

Gjatë hartimit të projekt-zbatimit duhen parashikuar:

- Perspektiva e rritjes së popullsisë sipas PPV dhe drejtimi i zhvillimit urbanistik të zonës;
- Ruajtja e rrjetit ekzistues që ka kapacitetin e mjaftueshëm përcjellës dhe është në gjendje të mirë pune;



Sugjerohet të përdoren tuba polietileni të brinjëzuar të llogaritura për të përballuar ngarkesat. Megjithatë grupi i projektimit do të argumentojë materialet që do të përdoren për çdo nën objekt. Duhet të parashikohet edhe lidhja e privatëve me pusetat e kontrollit.

#### **4.3. KANALIZIMET E UJËRAVE TË BARDHA**

Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha duhet të jetë i përshtatshëm për nevojat e zonës, në varësi të reshjeve dhe të sigurojë qëndrueshmëri dhe siguri në menaxhimin e ujërave të bardha.

Për rrjetin ekzistues të merret paraprakisht informacion, të kryhen të gjitha azhurnimet e nevojshme në terren dhe të përcaktohet pika funksionale e lidhjes.

Për sasitë e reshjeve si vlerat e llogaritjes së shiut, periudha e përsëritjes, kohëzgjatja, etj, të do të përdoren të dhënat e Institutit të Gjeoshkencave dhe mënyra e llogaritjes do të paraqitet nga projektuesi në mënyrë të argumentuar. Siguria llogaritëse e ujërave të shiut do të llogaritet 25% për kolektorët kryesorë dhe 40% për kolektorët sekondarë.

Sugjerohet të përdoren tuba polietileni të brinjëzuar të llogaritura për të përballuar ngarkesat. Megjithatë grupi i projektimit do të argumentojë materialet që do të përdoren për çdo nën objekt. Të verifikohen dhe të parashikohen lidhjet e ullkëve të shkarkimit të tarracave dhe të ujërave të bardha të oborreve me rrjetin e K.U.B. që do realizohet.

#### **4.4. RRJETI I UJËSJELLËSIT**

Në bashkëpunim me Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër do të saktësohet dhe gjendja e ujësjiellësit ekzistues, projektet që ka kjo ndërmarrje, problemet e vërejtura në këtë zonë, si dhe pika funksionale e lidhjes me rrjetin ekzistues. Norma e furnizimit e rekomanduar do të jetë 150 l/ditë/banor. Materialet, që do të përdoren për tubacionet e ujësjiellësit do të jenë tuba polietileni HDPE për 10atm, që plotësojnë normativat në fuqi, kanë përbërjen kimike dhe aftësinë mbajtëse ndaj presioneve të llogaritura. E njëjta gjë vlen edhe për pajisjet hidraulike dhe aksesoret. Saraçineskat dhe pajisjet e tjera hidraulike, që do të përdoren duhet të jenë  $P_n=16$  atm. Për nyjet do të parashikohen puseta me kapak b/a, përmasat e të cilave duhet të realizohen sipas kushteve teknike dhe të sigurojnë kushte normale manovrimi dhe riparimi. Pusetat duhet të jenë të pajisura me shkallë metalike në rastet kur janë të thella.

Të verifikohen nga grupi i projektimit në bashkëpunim me Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër vendi i kasetave për sahatët e matjes së ujit dhe të llogariten punime përkatëse për vendosjen ose spostimin e tyre.

#### **4.5. SISTEMI I NDRIÇIMIT RRUGOR**

Ndriçimi të bëhet me ndriçues shtyllor konform parametrave të ndriçimit rrugor dhe të hapësirave publike, duke respektuar normat e ndriçimit të përcaktuara në standardin: SSH-EN12301. Ndriçuesit duhet të jenë LED dhe të kenë efikasitet mbi 110Lm/W.

Të përcaktohet performanca e ndriçimit sipas përdoruesve: makina, biçikleta, këmbësor, etj.

Të përcaktohet lloji i rrugës sipas standardit EN 13201, në mënyrë që të përcaktohet lloji dhe intensiteti i ndriçimit. Jetëgjatësia e ndriçuesit LED sipas standardit IEC 62722-2-1. Ndriçimi duhet të jetë me ngjyrë të bardhë-të ngrohtë 3000K. Të përcaktohen termat e sigurisë, mbrojtja nga tensioni, nga lagështia etj. Linja të jetë me trase nëntokësore, ku të vendoset tub plastik fleksibël me dy shtresa për kalimin e kabullit të furnizimit dhe tub metalik për intersektim rruge.

Pusetat të jenë prej betoni me përmasa brenda përbrenda 40x40x40cm dhe të vendosen mbrapa çdo shtylle për tu mbrojtur nga dëmtimet e makinave. Panelet e komandimit të vendosen me komandim santeri me fotoelement.

Të parashikohet dalje energjie në puseta të veçanta për zonat e gjelbra. Furnizimi me energji i rrjetit të ndriçimit do të bëhet nga kabinat ekzistuese të zonës. Në këto kabina do të instalohen panelet e ndriçimit publik, të cilat do të ushqehen me ura të veçanta nga transformatori ekzistues. Në

kabinë do parashikohet dhe vendosja e matësve të energjisë. Do të parashikohet tokëzimi i shtyllave të ndriçimit. Të parashikohet dhe skema e furnizimit me energji elektrike për ndriçimin publik.

#### **4.6. RRJETI I FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE DHE I TELEKOMUNIKACIONIT**

Të parashikohet vendosja e infrastrukturës për rrjetin energjisë elektrike, internetit dhe telefonisë në përputhje me standardin shqiptar. Rrjeti i furnizimit me energji elektrike dhe rrjeti i telekomunikacionit të vendosen në sipërfaqen e rrugës me anë të tubave përkatës (për linjën elektrike dhe të telekomunikacionit) po ashtu përzgjedhja e tipit dhe dimensionit të linjës të bëhet në bashkëpunim me OSHEE. Të parashikohet dhe vendosja e pikave të lidhjes si për linjën kryesore ashtu edhe për abonentët. Në rastet ku kërkohet zhvendosja apo zëvendësimi i aseteve të OSSH-së (linjë kabllore, shtylla, kabina elektrike etj.), apo lidhje të reja të parashikohet jo vetëm mënyra e furnizimit me energji elektrike, por edhe shpenzimet e nevojshme për kryerjen e tyre. Të ndërtohet rrjeti i tubacioneve shpërndarëse të internet – telefonisë, sipas standardeve të përcaktuara duke marrë në konsideratë numrin e operatorëve operues në zonë, numrin e komunitetit përfitues, si dhe zhvillimin në perspektivë të këtij shërbimi, për një periudhë kohore 10 vjeçare. Ky rrjet duhet të shtrihet në të gjithë akset rrugore si dhe të ketë ndërlidhje me rrjetin ekzistues në zonat kufizuese rreth bllokut (ajror ose nëntokësore).

Duhet të respektohet standardi i rregullores Nr. 22 AKEP, mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike.

#### **4.7. GJELBËRIMI DHE MOBILIMI URBAN**

Grupi i projektimit do të trajtojë, përveç infrastrukturës në rrjetin rrugor, edhe të gjitha hapësirat e lira urbane që krijohen/mbeten nga bordura e trotuarit deri në kufirin e mureve rrethuese apo godinave përgjatë rrugës. Trajtimi i tyre të bëhet me elemente të rikualifikimit urban (shtrim, etj.), përveç elementëve të gjelbërimit të lartë apo të ulët sipas rastit dhe specifikave të vendndodhjes. Inkurajohet krijimi i hapësirave të gjelbra me funksione rekreative në shërbim të banorëve të zonës. Një vëmendje të veçantë, grupi i projektimit duhet t'i kushtojë edhe integritet të elementëve të mobilimit urban në këto hapësira (ose kur është rasti edhe të artit urban) si: stola, kosha të mbeturinave, pozicionimin e kontejnerëve të mbetjeve urbane (përcaktimi i tyre të bëhet në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër), zgara apo rrethime të pemëve, kangjella kufizuese në trotuare (kur është rasti), bllokues të mjeteve në trotuare, parkime për biçikleta, lojëra fëmijësh, etj. Të gjithë elementet e mobilimit duhet të jenë të projektuara me materiale që të garantojnë siguri, qëndrueshmëri në kohë dhe mirëmbajtje sa më të ulët. Integrimi me elemente me temë riciklimin dhe ndërgjegjësimin ndaj ambientit shihet si vlerë e shtuar. Koshat për hedhjen e mbeturinave duhet të jenë të komandueshëm për tu pastruar lehtësisht nga shoqëritë përkatëse të pastrimit, dhe kjo duhet të specifikohet në projekt në detajet përkatëse.

Grupi i projektimit duhet të trajtojë këto elementë në fazën e projektit të zbatimit (me të dhëna të plota për furnizim-vendosje), ku të përcaktojë detaje tip, frekuencën e vendosjes, pra skemën e shpërndarjes së tyre, llojin e materialit, detaje të inkastrimit, ngjyrat, sasinë, zërin në preventiv etj.

#### **4.8. SINJALISTIKA DHE SIGURIA RRUGORE**

Grupi i projektimit duhet të realizojë sinjalistikën vertikale dhe horizontale për t'i dhënë përdoruesve të rrugëve dhe hapësirave publike informacionin e duhur për të qarkulluar në mënyrë të sigurt.

Për sinjalistikën horizontale do të përdoret bojë speciale bikomponente. Sinjalistika vertikale duhet të pasurohet me të gjitha tabelat e nevojshme. Llojet e sinjaleve rrugore, vertikale dhe horizontale,



të vlefshme për përdorim, jepen në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë (Korrik 1998) dhe “Rregulloren e Zbatimit të Kodit Rrugor Shqiptar” (Prill 2001). Në territore me ndërtime, tabelat duhet të vendosen më lart. Kur ato ngrihen në trotuare apo ku ka lëvizje këmbësorësh, duhet të lejojnë një qartësi të mjaftueshme për këmbësorët: preferohet 220cm si minimum. Pranë kryqëzimeve të vendosen sinjalistikë vertikale për secilën rrugë sipas senseve të orientimit përkatës. Duhet pasur parasysh të gjithë elementët e sigurisë rrugore, ku sinjalistika është vetëm një komponent i saj. Të merren në konsideratë problemet e mundshme të sigurisë në lidhje me përdoruesit e rrugëve, sipas kategorive, ku hyjnë në mënyrë të përgjithshme elementët për mjetet (dukshmeria, hyrje-daljet, parakalimi, gjerësia e korsive për qarkullim të përzier të mjeteve, pikave të konfliktit në një kryqëzim etj.) e deri te këmbësorët në parashikimin e pikave të kalimit dhe krijimin e rampave.

Të trajtohet në projekt mënyra e lëvizjes si dhe masat e sigurisë së këmbësoreve gjatë punës për realizimin e objektit në të gjitha fazat. Grupi i projektimit duhet të paraqesë në flete të veçanta të gjitha detajet e nevojshme të masave të sigurisë që do të reflektohen në preventiv. Skema e rrjetit rrugor dhe plani i propozuar i ndërhyrjes për lirimin e sheshit të ndërtimit (prishjet) do të diskutohen me Bashkinë dhe pasi të merret miratimi, projektuesi vazhdon me detajimin e projekt-zbatimit të rrugës.

#### 4.9. KOSTO E PROJEKTIT

Vlera limit e parashikuar për zbatimin të projektit për objektin: Rikonstruksion Rruga "Bregu i Detit" Velipojë Loti II është **16,452,000 Lekë me T.V.SH.** Kostoja do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimet teknike, duke marrë parasysh edhe kërkesa të veçanta të Bashkisë Shkodër në lidhje me standardet e pranura dhe me çmimet për njësi sipas “Sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” miratuar me VKM nr. 216, datë 13.4.2023 dhe analiza çmimesh.

### 5. SHËRBIMET E KËRKUARA

Grupi i projektimit është i detyruar të bashkëpunojë në mënyrë të ngushtë me Strukturat e Pushtetit Vendor si dhe me subjekte të tjera që paraqesin interes për zgjidhjen e projektit me qëllim për të siguruar azhurnimet aktuale për paraqitjen e varianteve më të përshtatshme, për plotësimin e elementet e nevojshëm të infrastrukturës, për plotësimin e dokumentacionit të shpronësimeve dhe miratimet ligjore në organet përkatëse.

Gjithashtu Grupi i projektimit duhet të mbështetet dhe të konsultohet me studimet dhe Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër, në rast se do propozojë modifikime nga gjurma ekzistuese.

#### Shërbimi i kërkuar do të përfshijë por jo të limitohet në:

- Kryerjen dhe studimin e plotë për të gjetur alternativën tekniko-ekonomike-mjedisore më të mirë, për të ndërtuar një shesh publik dhe segmente rrugore sipas standardeve shqiptare.
- Analiza e detyrës së projektimit që do të përfshijë rekomandime të qarta për çdo fazë të hartimit të projektit.
- Mbledhja, azhurnimi dhe analizimi i rrjetit të infrastrukturës me të gjitha të dhënat e nevojshme për projektim siç janë gjendja ekzistuese e kanalizimeve, ndriçimit, kabinat e tensionit të lartë, rrjeti i telefonisë do të merren tek institucionet përkatëse;
- Rilevimi i zonës për saktësinë e të dhënave përpara fillimit të projektimit që të evitohen pasaktësitë;
- Hartimi i analizës së kostove dhe përfitimeve për secilin variant;
- Kompletimi i projekt idesë paraprake për alternativat e përzgjedhura;

- Trajtimi i projektit nga pikëpamja teknike (mjedisore, inxhinierike, gjeoteknike, ekonomike, planifikimit të trafikut, sigurisë rrugore, etj.);
- Paraqitja e një programi për realizimin e projekt idesë paraprake, projekt idesë përfundimtare, projektit të zbatimit, dokumentacionin për tenderimin dhe dokumentacionin e nevojshëm për leje ndërtimi;
- Grupi i projektimit sipas fazave të projektit të përcaktuara më poshtë do të analizojë dhe të japë të dhëna të hollësishme për shpronësimet e tokës apo objekteve duke dhënë të qarta kufijtë e shpronësimeve dhe llogaritjet e sipërfaqeve sipas pronarëve duke u mbështetur dhe bashkëpunuar me ASHK dhe Pushtetin Lokal.

Fazat e projektit do të jenë si më poshtë:

- Faza I. **Analiza e detyrës së projektimit dhe përcaktimi i bazës së projektit;**
- Faza II. **Projekt ideja paraprake;**
- Faza III. **Projekt ideja përfundimtare;**
- Faza IV. **Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit;**
- Faza V. **Projekti i zbatimit;**
- Faza VI. **Preventivi përfundimtar;**
- Faza VII. **Miratimi i oponencës teknike;**

Secila nga këto faza duhet të bëhet në konsultim të vazhdueshëm me stafin e Bashkisë Shkodër.

## **FAZA I : ANALIZA E DETYRËS SË PROJEKTIMIT DHE PËRCAKTIMI I BAZËS SË PROJEKTIT**

Detyrat më kryesore që do të përfshihen gjatë kësaj faze janë si më poshtë:

- Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit;
- Rishikimi dhe vlerësimi i të dhënave ekzistuese, informacionet, fotografi ajrore, harta dhe njohuri nga të gjitha fushat kryesore nëpërmjet një studimi të të dhënave ekzistuese dhe inspektimi të detyrueshëm në terren nga ana e grupit të projektimit;
- Analizimi i informacionit të mbledhur për të gjitha fushat kryesore (mjedisin, gjeologjinë, topografinë, sigurinë rrugore, vëllimin e trafikut, etj.);
- Kryerja e kërkimeve shtesë që nevojiten për të plotësuar mungesat në informacionin që kërkohet për marrjen e vendimeve të sakta;
- Trajtimi i projektit nga pikëpamja teknike (mjedisore, inxhinierike, gjeoteknike, ekonomike, planifikimit të trafikut, sigurisë rrugore, etj.);
- Paraqitja e një programi për realizimin e projekt idesë paraprake, projekt idesë përfundimtare, tenderimin e punimeve dhe ndërtimin e veprës;
- Dhënia e rekomandimeve.

## **FAZA II: PROJEKT IDEJA PARAPRAKE**

Në këtë fazë grupi i projektimit duhet të shqyrtojë jo më pak se dy variante të sheshit por duke mos e kufizuar atë për të studiuar dhe paraqitur dhe variante apo nën variante tjera që ai do t'i shohë të arsyeshme ti paraqesë.

- Vlerësimi dhe paraqitja e varianteve të ndryshme;
- Grupi i projektimit do të paraqesë për çdo variant avantazhet dhe disavantazhet duke dhënë dhe mendimin e tij për variantin që ai përcakton më të arrirë;
- Paraqitja e një koncepti planifikimi, përfshirë studimin e zgjidhjeve të mundshme të varianteve të paraqitura;
- Hartimi i analizës së kostove dhe përfitimeve për secilin variant;
- Dhënia e rekomandimeve.

Përveç sa më sipër, grupi i projektimit duhet të përgatisë dokumentet e mëposhtme:

- Projekt ideja paraprake për ndërhyrje të re ose përmirësim të rrugës ekzistuese do të zhvillohet në detaje të mjaftueshme për të nxjerrë vlerësimet e kostos reale. Standardet e përgjithshme të projektimit të miratuara do të jenë në përputhje me standardet e projektimit dhe ligjet në Shqipëri.
- Seksionet tërthore të reja të sheshit ose ato të përmirësuara do të marrin aprovimin, së bashku me të gjitha detajet e tjera ndërtimore që kanë një ndikim të rëndësishëm të kostos, të tilla si rrjeti i kanalizimeve K.U.B, K.U.Z. ujësjellësi, ndriçimi publik.
- Projekti ideja paraprake duhet të trajtojë: sistemin kanalizimeve të ujërave të zeza; sistemin kanalizimeve të ujërave të bardha; shtresat rrugore; rrjetin e ujësjellësit; sistemin e ndriçimit rrugor; rrjetin i furnizimit me energji elektrike dhe rrjetin e telekomunikacionit; gjelbërimin, rrjetin i sinjalistikës; shpronësimet dhe sigurinë rrugore.
- Studimi gjeologo-inxhinierik;
- Raporti i Studimit hidrologjik dhe klimaterik;
- Llogaritja e elementëve të veçantë;
- Analiza e kostos paraprake. Kjo analizë paraqet llogaritje krahasuese për disa mundësi zgjedhësh, duke përfshirë dhe shpronësimet në qoftë se ka.

### **FAZA III: PROJEKT IDEJA PËRFUNDIMTARE**

Me plotësimin e të gjithë dokumentacionit mbështetës si dhe bazuar në variantin përfundimtar të miratuar të projekt idesë, grupi i projektimit do të hartojë projekt ide-në përfundimtare, e cila duhet të trajtojë detajet si më poshtë:

- Kryerjen e vëzhgimeve që synojnë në eliminimin e hamendësimeve të bëra gjatë fazave më të mëparshme;
- Përditësimin e llogaritjeve dhe zëvendësimin e hamendësimeve të bëra më parë;
- Përgatitjen e metodologjisë së përgjithshme të ndërtimit;
- Përgatitjen e programit të punimeve;
- Përgatitjen e vlerësimit të kostos duke krahasuar variantet;
- Ndikimet ndaj mjedisit;
- Projekt-ideja përfundimtare duhet që të paraqesë në formë të përgjithshme zgjidhjet përfundimtare të varianteve të propozuara të projektit;

Mbi sa më sipër grupi i projektimit gjatë kësaj faze do të përgatisë dhe të paraqesë për miratim studimet që vijojnë;

- Raporti i llogaritjes së shtresave rrugore dhe të sheshit,
- Raporti i Shpronësimeve. (Ky raport do të paraqesë një listë të mundshme shpronësimesh së bashku + me kërkesat dhe procedurat ligjore që duhet të plotësohen në lidhje me projektin. Lista do të përmbajë sipërfaqen e tokës apo objekteve ndërtimore ku do të kryhet vlerësimi i kostos së pronave private të cilat preken nga projekti.)
- Studimi gjeologo-inxhinierik. (Ky studim do të paraqesë rezultatet ekzistuese të përfituara prej shpimeve apo mostrave të materialeve të nxjerra gjatë fazës së projekt-idesë duke marrë parasysh dhe studimet e bëra në projekte të mëparshëm.)
- Vlerësimi i ndikimit në mjedis. (Sipas ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, do të kryhet raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis.)

## **FAZA IV: PROJEKTI PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT**

Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore të sistemit të lejeve sipas legjislacionit shqiptar në fuqi (si në nivel vendor ashtu dhe atë qendror).

Grupi i projektimit duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar marrjen e të gjitha llojeve të lejeve që mund të nevojiten, sikurse plotësimin me dokumentacionin e nevojshëm për aplikimin për lejet respektive.

## **FAZA V : PROJEKTI I ZBATIMIT**

Në këtë fazë dhe mbi bazë të variantit përfundimtar të miratuar, grupi i projektimit do të hartojë projektin e zbatimit i cili përfshin përgatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për të ndërmarrë procesin e tenderimit dhe të ndërtimit të objektit, i cili përgjithësisht duhet të përmbajë por jo të kufizohet në:

- Përgatitja e projektit përfundimtar, vizatimet dhe vlerësimin e kostos, detajimeve të nevojshme, specifikimeve teknike, etj. Në këtë dokumentacion do të përfshihet puna e plotë, civile, arkitektonike, strukturore, mekanike, elektrike, sinjalistika dhe siguria rrugore, detaje të projektimit dhe vizatime për të gjitha komponentët e punës për realizimin e projektit pa nevojën e modifikimeve të mëvonshme.
- Paraqitja e projektit në formë grafike me të gjitha detajet e nevojshme për zbatim, vizatime të detajuara shoqëruar me relacionin përkatës.
- Paraqitja e raporteve përfundimtare si: Raporti i Studimit Topografik, Raporti i Studimit Gjeoteknik, Raporti i Studimit Hidrologjik e Klimaterik, Raporti i Llogaritjes së Shtresave Rrugore dhe të Sheshit, Raporti i Studimit Gjeologo-inxhinierik.
- Përgatitja e bazës, për specialistët e tjerë të përfshirë në projekt dhe përfshirja e tyre në fazën e zbatimit.
- Azhurnimi i vazhdueshëm i projektit gjatë fazës së zbatimit.

## **FAZA VI: PREVENTIVI PËRFUNDIMTAR**

Bazuar në llogaritjet dhe vizatimet e projektit, grupi i projektimit do të hartojë një liste me të gjitha zërat e punimeve që janë pjesë përbërëse e listës përfundimtare të volumeve (Preventivi).

Preventivi do të shoqërohet me tabelat e volumeve dhe mënyrën e llogaritjes së tyre. Çmimet do të jenë ato njësi të miratuara në VKM nr. 216, datë 13.4.2023. Zërat e punimeve që për ndonjë arsye nuk janë përfshirë në listën e çmimeve njësi të miratuar do të shoqërohen me analizën e llogaritjes të çmimit.

## **FAZA VII: MIRATIMI I OPONENCËS TEKNIKE**

Detyrat kryesore, të grupit të projektimit, që do të përfshihen gjatë kësaj faze janë:

- Dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e oponencës teknike për projektet infrastrukturore, sipas përcaktimeve të VKM Nr. 9, datë 11.1.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”, pranë institucionit që është përgjegjës për kryerjen e oponencës teknike;
- Ndryshimi i dokumenteve sipas kërkesës të institucionit përgjegjës për kryerjen dhe miratimin e oponencës teknike. Çdo ndryshim që lind si nevojë e plotësimit të kushteve për miratimin e oponencës, duhet të miratohet paraprakisht nga Bashkia Shkodër.

## 6. PARAQITJE E DOKUMENTACIONIT

I gjithë dokumentacioni i dorëzuar duhet të jetë në përputhje me kërkesat e Ligji Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar) dhe VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” (i ndryshuar), për pajisjen me leje ndërtimi.

I gjithë projekti duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Deklaratat e projektuesve të licencuar, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit, nëpërmjet së cilës konfirmohet përputhshmëria e projektit me dokumentet e planifikimit e kontrollit të zhvillimit, në fuqi, dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri dhe higjieno-sanitare;
- Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet,
- Kopje e policës së sigurimit të projektuesve, për mbulimin e përgjegjësisë profesionale;

Projekti përfundimtar i zbatimit duhet të përmbajë minimumi raportet si më poshtë (formati A4):

- Raporti përfundimtar i studimit Topografik të zonës;
- Raporti përfundimtar i studimit Gjeologo-inxhinierik;
- Raporti përfundimtar i studimit Hidrologjik dhe Klimaterik si dhe llogaritjet hidraulike;
- Raporti përfundimtar i Shpronësimeve ku paraqiten ekstraktet kadastrale nga rregjistrat ose dokumente të tjera zyrtare;
- Llogaritjet e veprave të artit të firmosura nga inxhinieri;
- Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (Në rastet kur kërkohet miratimi i Ministrisë së Mjedisit për VNM Paraprake/Thelluar të dorëzohet dokumentacioni i plote në përputhje me Ligjin Nr.10/440, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” (i ndryshuar);
- Raporti teknik përfundimtar;
- Specifikimet teknike;
- Grafiku i punimeve;
- Preventivi përfundimtar;

Projekti përfundimtar i zbatimit duhet të përmbajë minimumi fletët (minimalisht format A3) si më poshtë:

- Horografia në shkallën 1:1000. Në raste që zona e studimit është shumë e madhe duhet të përgatitet një hartë përmbledhëse në një shkallë të përshtatshme;
- Harta e rievimit topografik, SH 1:500;
- Planimetritë e shpronësimeve SH 1:500;
- Planimetri e hollësishme e rrugës në shkallë 1:100;
- Profil gjatësor i rrugës, SH 1:100 V 1: 100;
- Profile tërthor të rishikuar të rrugës çdo 25 m si dhe në vendet me karakteristika të veçanta si, kryqëzime etj., SH 1: 100;
- Profile tërthor tip së bashku me të gjitha hollësitë e nevojshme, SH 1:25;
- Vizatimet e tombinove (llojet vendndodhja numri pjerrësia), SH 1:50;
- Planimetri për kryqëzimet dhe detaje përkatëse SH 1:200;
- Projekti elektrik ku të përfshihet: planimetria e ndriçimit dhe detaje të ndriçimit të sheshit, relacioni firmosur nga inxhinieri elektrik;
- Harta hidrologjike të rishikuar ku të tregohen qartë rrjedhjet ujore, SH 1:1000;
- Harta gjeologjike së bashku me planimetrinë e rrugës (shoqëruar me detaje gjeoteknike të disponueshme), SH 1:1000; apo veprave të artit;



- Plani i sinjalistikës rrugore vertikale dhe horizontale të propozuar, SH 1:100;
- Vizatime të mureve mbajtës apo pritës (së bashku me përforcime) n.q.s. ka, SH 1:50;
- Punime suplementare dhe ndihmëse (këtu mund të përfshihen vend pushime anësore, rruge shërbimi pajisjet rrugore, punime spostimesh, instalime të linjave nëntokësore apo mbitokësore, rrethimet elemente të drenazhimit, etj.), shkalla e vizatimeve të përshtatet me detajet që paraqiten;
- Zonat ku do të merren materialet e ndërtimit lëndë e parë përfshirë dhe punimet e përkohshme vendet e depozitimeve etj., SH 1:1000;

## 7. STANDARDET NË PROJEKTIM

Projekti duhet të hartohet mbështetur në zbatim të akteve ligjore apo nënligjore në fuqi për Kushtet Teknike të Projektimit. Është përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE – së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim, te cilat nuk bien në kundërshtim me legjislacionet në fuqi.

Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare, si dhe kufizimet për financimin e veprës.

Projektuesit gjatë procesit të projektimit, duhet të zbatojnë:

- Normat dhe standardet e projektimit e zbatimit sipas legjislacionit në fuqi;
- Normat dhe standardet PAK;
- Praktikën më të mira evropiane.

## 8. RAPORTIMI

Të gjitha fazat e projektit duhet të bëhen në konsultim të vazhdueshëm me stafin e Bashkisë Shkodër dhe dorëzimet duhet të bëhen minimalisht sipas etapave:

|         |                                                                                                                                                                                        |                                   |
|---------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------|
| Etapa 1 | Përfshin të gjitha materialet e përgatitura gjatë Fazës I. Analiza e detyrës së projektimit dhe Fazës II Projekt ideja paraprake.                                                      | 1/4 Afatit                        |
| Etapa 2 | Përfshin të gjitha materialet e përgatitura gjatë Fazës III. Projekt ideja përfundimtare.                                                                                              | 1/4 Afatit                        |
| Etapa 3 | Përfshin të gjitha materialet e përgatitura gjatë Fazës IV-VI. Dorëzimi i projekti i zbatimit, konform kriterëve për miratimin e lejes së ndërtimit dhe miratimin e oponencës teknike. | 2/4 Afatit                        |
| Etapa 4 | Përfshin të gjitha materialet e përgatitura gjatë Fazës VII. Dorëzimi i dokumenteve pranë institucionit përgjegjës për oponencën, dhe miratimi i oponencës teknike.                    | Në varësi të institucionit përgj. |

Dorëzimet duhet të bëhen me shkresë zyrtare, shoqëruar me fletë inventari, pranë Bashkisë Shkodër duke respektuar afatet e sipërpërmendura.

Në përfundim të secilës etapë projektuesi ka detyrim të marrë miratimin e Bashkisë Shkodër.

Kërkesat apo sugjerimet nga ana e Bashkisë Shkodër duhet të reflektohen sa më parë në materialin e dorëzuar dhe detyrimisht brenda etapës pasardhëse.

Dorëzimet për etapat 1,2 dhe 3 duhet të paraqiten në 2 kopje të printuara dhe në format dixhital.

Projekti përfundimtar, pasi të merret miratimi i opionencës teknike, do të dorëzohet në 4 kopje të printuara dhe 2 kopje CD në versionin e dixhitalizuar, ku një CD do të përmbajë punimet në format të përpunueshëm DWG, Office Word-Excel, dhe një CD do të përmbajë të gjithë dokumentacionin në format PDF. I gjithë dokumentacioni që përmbajnë CD sipas formatit PDF do të jenë të firmosura elektronikisht, ku secili material PDF të jetë jo me shume se 20mb, sipas kërkesave për pajisje me leje të përcaktuara në bazë të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar), si dhe VKM-së nr. 408 datë 13.5.2015 ”Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit“ (i ndryshuar).